

# KONTRATE DHURIMI TE KUOTAVE TE KAPITALIT



Sot, me Tirane, me daten 21.10.2003 ( njezet e nje tetor te vitit dymijë e tre), bazuar ne nenin 761 e vijues te Kodit Civi si dhe ligjit nr. 7638, date 19/11/1992 „Per Shoqerite Tregtare“, lidhet kjo kontrate per dhurimin e kuotave ne zoterim te kapitalit ne shoqerine “ Teknotrade” sh.p.k. mes paleve :

**DHURUESI :** Gianfranco Liuzzi, i biri i Oronzo, lindur me 6/04/1947 me Locorotondo, Bari, Itali, shtetas italian, mbajtes i pashaportes me numer 652377 N dhe banues ne Bari, Via „Conte Giusso“ 13/e, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut te Shoqerise „Teknotrade“sh.p.k qe zoteron 49 % (dyzet e nente perqind) te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, me seli ne Tirane Rruga „ Tefta Tashko“104/6, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 te Gjykates se Rrethit Tirane.

**PRANUES I DHURIMIT :** Geront Selenica, i biri i Mustafait, i datelindjes 20.05.1966, lindur dhe banues ne Tirane ne RR „Myslym Shyri“, p.7, shk.5, Ap.50, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr. Z.0184918, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me cilesine e Ortakut te Shoqerise „Teknotrade“sh.p.k qe zoteron 40 % (dyzet perqind) te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, me seli ne Tirane Rruga „ Tefta Tashko“104/6, regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Me vendimin e asamblese se jashtezakonshme te ortakeve te shoqerise „TEKNOTRADE“ sh.p.k eshte miratuar transferimi i kuotave te kapitalit themeltar me ane te dhurimit nga ortakut **Gianfranco Liuzzi** ortakut tjetër **Geront Selenica**. **Dhuruesi, Gianfranco Liuzzi**, ortakut i shoqerise „Teknotrade“ sh.p.k,qe zoteron 49% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, e cila ka fituar personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane me Vendimin nr. 7662, date 19/10/1993 , **i dhuron dhe Perfituesi i dhurimit, Z. Geront Selenica** edhe ky ortak i shoqerise „Teknotrade“ sh.p.k,qe zoteron aktualisht 40% te kuotave te kapitalit te kesaj shoqerie, **i pranon dhurimin e te gjitha kuotave te kapitalit qe dhuruesi zoteron ne shoqerine “ Teknotrade”sh.p.k**

**Dhuruesi,** dhe **Perfituesi i dhurimit** me vullnetin e tyre te lire kane rene dakort si me poshte :

## NENI 1

### Objekti i Dhurimit

**Dhuruesi** i dhuron **Perfituesi i dhurimit** te gjitha kuotat e kapitalit qe ai zoteron ne shoqerine „ Teknotrade “ sh.p.k, qe aktualisht jane 49 % ( dyzet e nente perqind) te

kuotave te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "Teknotrade" sh.p.k, e shprehur ne vlere monetare keto kuota jane te barazvlereshme me 12 895 000 (dymbjedhetemilioneqindenedhjetepese) leke.

**Dhuruesi** Gianfranco Liuzzi, pas nenshkrimit te kesaj kontrate largohet nga shoqeria „Teknotrade“ sh.p.k duke hequr dore dhe nga funksioni si administrator i shoqerise.

## NENI 2

### Formimi i Kapitalit te Shoqerise

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, kapitali I shoqerise "Teknotrade" sh.p.k formohet si me poshte :

1. Z. Geront Selenica zoteron 89 kuota qe perbejne 89% ( tetedhjetë e nente perqind) te kuotave te kapitalit te shoqerise „ Teknotrade “ sh.p.k. dhe ne vlere monetare 23 585 000(njezetetremilioneqindetetedhjetepesemije) leke.
2. Shoqeria " The Point" sh.p.k zoteron 11 kuota qe perbejne 11 % ( njembjedhjetë perqind ) te kuotave te kapitalit te shoqerise „ Teknotrade “ sh.p.k.dhe ne vlere monetare 2 915 000(dymilioneqindepesembjedhetemije)leke.

## NENI 3

### Garancia e Dhurimit

**Dhuruesi** garanton **Pranuesin e Dhurimit** se objekti i dhurimit ( 49% e kuotave te kapitalit te shoqerise " Teknotrade" sh.p.k ) eshte ne pronesi te tij ne momentin e dhurimit.

**Dhuruesi** garanton **Pranuesin e Dhurimit** se objekti i dhurimit ( 49% e kuotave te kapitalit te shoqerise " Teknotrade" sh.p.k ) eshte i plote dhe nuk mund te pesoje zvogelim nga te tretet per shkak te detyrimeve te krijuara ndaj tyre para dates se nenshkrimit te kesaj kontrate .

## NENI 4

### Ligji i aplikueshem dhe zgjidhja e mosmarrveshjeve

Kontrata eshte e bazuar ne legjislacionin shqiptar.

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin ne interpretimin dhe zbatimin e kesaj Kontrate si dhe ne pergjithesi te gjitha mosmarrveshjet midis Dhuruesit dhe Perfituesit te Dhurimit, ne qoftese nuk zgjidhen me mirekuptim midis paleve do te zgjidhen ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.



NENI 5

Gjuha e kontrates

Kjo Kontrate eshte hartuar ne kater kopje origjinale.

Kontrata pasi u lexua u firmos rregullisht nga palet.

**DHURUESI**

Gianfranco LIUZZI

*GIANFRANCO LIUZZI*  
*gs liuzzi*

**PRANUESI I DHURIMIT**

Geront SELENICA

*Gerant Selenica*  
*[Signature]*